



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 4620 Prot

Shkodër, më 12.03.2020

VENDIM

Nr. 84, datë 12.03.2020

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE TË ZËRAVE TË SHPENZIMEVE KORENTE, BRENDA TË NJËJTIT PROGRAM PËR VITIN 2020

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pika 2, neni 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”, kreu III “Të drejtat dhe përgjegjësitë e njësisive të vetqeverisjes vendore“, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.88/2019 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 20.01.2020 “ Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, VKB nr. 26 , datë 30.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2020 - 2022 të Bashkisë Shkodër”, në kuadër të masave të marra për përballimin e situatës së krijuar nga shfaqja e rasteve të para nga koronavirusi, në mbështetje të urdhërave nga dikasteret qendrore , në zbatim të Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, nr.1303prot. datë 09.03.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së CONVID-19”, në zbatim të Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, nr.132 datë 09.03.2020 dhe bazuar në urdhërin nr.230, datë 09.03.2020.të Kryetarit të Bashkisë “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike, anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, mbylljen e institucioneve arsimore dhe parandalimin e përhapjes së CONVID-19”, me qëllim kryerjen e shërbimit për dezinfektimin dhe higjenizimin e rrugëve dhe shesheve publike dhe sipas relacionit nr.983/b prot. datë 12.03.2020 të Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës për miratimin e ndryshimit në rishpërndarje të buxhetit të Bashkisë për Vitin 2020 brenda programit 05100, në fish projektin P05100.O1.A1.A1/1 Shërbimi i pastrimit zona "qytet".

VENDOSA

1. Për miratimin e rishpërndarjes së fondit brenda programit 5100, Shërbime Publike nga zëri i shpenzimeve operative (Art.602) në zërin shpenzimeve operative, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Bashkia Shkodër si më poshtë:

Pakësime

Nr	Programi	Emërtimi	Artikulli 602 Mallra dhe Shërbim
1	5100 (5)	P05100.O1.A1.A1/1 Shërbimi i pastrimit zona "qytet".	754,800 Lekë
		Totali	754,800 Lekë

Shtesë

Nr	Programi	Emërtimi	Artikulli 602 Mallra dhe Shërbim)
1	5100 (5)	P05100.O1.A1.A1/6 Blerje materiale dezinfektuese	754,800 Lekë
		Totali	754,800 Lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zv. Emilia Kolici

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes

së Investimeve të Infrastrukturës

Drejtoria Juridike



Drejtoria e Financës

Drejtoria e Analizës dhe Programimit

Buxheter